
**KONTRATË SHITJE AKSIONESH
TË SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM GAS” Sh.A.**

Sot, në Tiranë, më datë 16.09.2021 (dymijë e njëzet e një), hartohet kjo kontratë e shitjeve të aksioneve ndërmjet palëve si më poshtë:

Shitesi: **z. Naim Kasa**, shtetas shqiptar, lindur me 26.07.1967 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit ID me Nr. 032401719 dhe Nr. Personal G70726040I, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “**Shitësi**”);

dhe

Bleresi: **Z. Isuf Berberi**, shtetas shqiptar, lindur me 24.07.1969 ne, Vlore e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit ID me Nr. 029109110 dhe Nr. Personal G90824125M, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “**Blerësi**”);

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- a. Shoqëria “Phoenix Petroleum Gas” Sh.A., është një shoqëri aksionare, e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L11620009U, me seli ne Rruga e Elbasanit, Pallati i Ri, (ngjitur me Fakultetin e Gjeologji Minierave), Kulla IMC 6/7, Kati 3, Tiranë, Shqipëri (“**Shoqëria**”), me nje kapital prej 3.500.000,00 Leke, i ndare ne 100 aksione me vlere prej 35.000 leke secili dhe sikurse rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar lëshuar nga QKR për të dhënat e Shoqërisë, Shitësi zotëron 25 % (njëzet e pesë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- b. Shitësi i ka njoftuar Blerësit ofertën e tij për shitjen e 25% (njëzet e pesë për qind) te aksioneve te kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe Blerësi ka pranuar të blejë aksionet e zotëruara dhe të ofruara nga Shitësi në Shoqëri;
- c. Në zbatim të kërkesave të ligjit dhe Statutit të Shoqërisë, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

1.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi bie dakord që të shesë dhe Blerësi bie dakord që të blejë gjithsej 25 (njëzet e pesë) % të aksioneve te kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i shitjes së 25% (njëzet e pesë) te aksioneve ne kapitalin e shoqerise eshte 875,000 LEKË (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë lekë).



2.2 Çmimi i shitjes së aksioneve do të paguhet në llogarinë bankare të shitësit dhe mandate bankare do të përbejnë prove për kryerjen e pagesës.

Neni 3 Deklarimet dhe garancite

3.1 Shitësi deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron aksionet që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'i transferuar këto aksione dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Shitësi.

3.2. Blerësi deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Blerësi ka tagra të plota për të pranuar aksionet nga Shitësi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Blerësi.

Neni 4 Transferimi i të drejtave mbi aksionet

4.1. Pronësia mbi aksionet e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së aksioneve të Shoqërisë në favor të Blerësit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin 9901/2008, të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, të ndryshuar.

4.2. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kapitalit themeltar të Shoqërisë do të jetë si vijon.;

- *Z. Isuf Berberi, bëhet zoterues i 100 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;*

4.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi aksionet e zotëruara në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5 Të ndryshme

5.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.



5.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 2 (dy) kopje origjinale.

SHITËSI

NAIM KASA

BLERËSI

ISUF BERBERI

